



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.90/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 23.01.2025, mori këtë:

#### VE N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa A.nr.90/2025 e datës 21.01.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025

#### A r s y e t i m

Me datë 21.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, në të cilën theksohet se me date 21.01.2025 aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, kane vërejtur se afër shkollës "Hamëz Jashari" në Skenderaj, në hapësirat e saj brenda kufirit në pronësi të shkollës gjendet një kombi i destinuar për bartjen e nxënësve minorë, që shërben për segmentet shkollë - shtëpi, i shfrytëzojnë jashtëligjshëm dritaret për reklamim të kandidatëve të subjektit politik PDK, duke renë ndesh me përdorimin e hapësirave publike si shkolla për qëllime politike, si dhe duke i ekspozuar të njëjtat në kombin për bartjen e fëmijëve, me çka konsiderojmë se është rreptësishtë e ndaluar me legjislacionin në fuqi lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve., përkatësisht janë shkelur dispozitat ligjore të nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës - LZP. Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur fotot e posterave në ankesë.

Më datë 22.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 22.01.2025 në ora 17:00, ku në përgjigjen në ankesë subjekti politik PDK, ka kërkuar nga PZAP që ankesën ta refuzoj si të pabazuar për arsye se vlerëson se kombi për bartjen e nxënësve që shërben për segmentet shkollë-shtëpi, nuk përbën shfrytëzim të hapësirave shkollore, e as publike, për faktin se i njëjti nuk përbën objekt statik dhe as nuk është në pronësi publike të shkollës apo komunës. Për më tepër, ankuesi me asnjë provë të vetme nuk ka arritur të argumentoj identitetin e pronarit të këtij kombi, në mënyrë që të bëjë ndërlidhjen me subjektin politik të PDK-së, dhe se rrjedhimisht nuk ka arritur as të argumentoj lidhjen kauzale në mes të veprimit dhe përgjegjësisë së subjektit politik PDK.

Për më tepër, njoftojmë se Partia Demokratike e Kosovës, më datë 17.01.2025, përmes rrjetit social Facebook i'u është adresuar të gjithë anëtarëve, aktivistëve dhe përkrahësve të PDK-së, duke i bërë thirrje të njëjtëve që gjatë kësaj periudhe kohore të fushatës të përdorin gjuhë të respektueshme, të shmangin çdo gjuhë nxitëse, fyese ose urrejtjeje si dhe të respektojnë ligjet dhe rregullat zgjedhore, të cilat përveç se përbëjnë detyrim ligjor, është edhe përgjegjësi morale që forcon demokracinë dhe ndërton themelet për suksesin e përbashkët, thuhet në përgjigje në ankesë.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik PDK, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 i cili përcakton” *Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim, paragrafi 2.2 vendosa e njoftimeve, pllakatave dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat e trafikut publik, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna, ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizata ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”.*

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës, paneli vlerësoi se nuk mund të identifikohet se automjeti i destinuar për bartje të nxënësve përmban poster, të ndonjë kandidati apo subjekti politik. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoi se pretendimet e palës ankuese se janë përdorur hapësira publike si shkolla për qëllime politike, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se subjekti politik LVV, nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime janë ndërmarr nga subjekti politik kundër të cilit është paraqitur ankesa, për të ardhur në përfundim se janë bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të Nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Anr.90/2025 më datën 23.01.2025

Kryesuese e Panelit  
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.